

**1. Identifikimi**

<b>Identifikuesi GHS i produktit</b>	<b>Çiftues për Valë Tërthore</b>
<b>Kodi i produktit</b>	SWC-2
<b>Versioni nr.</b>	03
<b>Data e publikimit</b>	18-janar-2016
<b>Data e rishikimit</b>	22-November-2022
<b>Zëvendëson datën</b>	-
<b>CAS #</b>	Përzierje
<b>Përdorimi i rekomanduar</b>	Çiftues.
<b>Kufizimet e rekomanduara</b>	Nuk ekziston.
<b>Fabrikanti</b>	EVIDENT Europe GmbH
<b>Furnitori</b>	
<b>Adresa</b>	Caffamacherreihe 8-10 20355 Hamburg Germany
<b>Telefoni</b>	+49 40-23773-3482
<b>Numri i Telefonit për Urgjenca</b>	CHEMTREC  SHBA: 1-800-424-9300, Ndërkombëtar: +1 703-527-3887

**2. Identifikimi i rrezikshmërive****Klasifikimi GHS**

<b>Rrezikshmëritë fizike</b>	Të paklasifikuara.
<b>Rrezikshmëritë Shëndetësore</b>	Të paklasifikuara.
<b>Rrezikshmëritë mjedisore</b>	Të paklasifikuara.

**Elementet e etiketës GHS**

<b>Fjala sinjalizuese</b>	Asnjë.
<b>Simbolet e rrezikshmërisë</b>	Asnjë.
<b>Deklarata e rrezikshmërisë</b>	Përzierja nuk i plotëson kriteret për t'u klasifikuar.

**Deklarata paralajmëruese**

<b>Parandalimi</b>	Adoptoni praktika të higjienës së mirë industriale.
<b>Përgjigjja</b>	Lani duart pasi ta keni trajtuar.
<b>Magazinimi</b>	Mos e magazinoni në vende të ekspozuara ndaj diellit.
<b>Eliminimi</b>	Eliminoni mbetjet dhe mbeturinat në pajtim me kërkesat e autoriteteve lokale.

**Informacion shtesë** Asnjë.**3. Përbërja/të dhëna për përbërësit**

Përbërësit nuk janë të rrezikshëm ose janë nën caqet e kërkuara për deklarim.

#### 4. Masa të ndihmës së parë

##### Procedura të ndihmës së parë

<b>Frymëthithje</b>	Zhvendosuni në ajër të pastër. Telefononi një mjek, nëse simptomat shfaqen ose vazhdojnë.
<b>Lëkura</b>	Lani me sapun dhe ujë. Kërkoni ndihmë mjekësore, nëse zhvillohet dhe vazhdon iritimi.
<b>Sytë</b>	Shpëlani me ujë. Kërkoni ndihmë mjekësore, nëse zhvillohet dhe vazhdon iritimi.
<b>Gëlltitje</b>	Shpëlajeni gojën. Kërkoni ndihmë mjekësore, nëse shfaqen simptoma.
<b>Simptomat dhe efektet më të rëndësishme, akute dhe të vonuara</b>	Kontakti i drejtpërdrejtë me sytë mund të shkaktojë iritim të përkohshëm.
<b>Shënime për mjekun</b>	Jepni trajtim simptomatik.
<b>Këshillë e përgjithshme</b>	Sigurohuni që personeli mjekësor është në dijeni të materialeve të përdorura dhe po marrin masa për t'u mbrojtur.

#### 5. Masa të mbrojtjes kundër zjarrit

<b>Mjete fikëse të përshtatshme</b>	Përdorni mjete zjarrfikëse të përshtatshme për materialet rrethuese.
<b>Mjete fikëse të papërshtatshme</b>	Asnjë që njihet.
<b>Rrezikshmëri specifike të kimikatit</b>	Gjatë zjarrit, mund të formohen gazra të rrezikshme për shëndetin.
<b>Pajisjet mbrojtëse dhe masat mbrojtëse për zjarrfikësit</b>	Në rast zjarri, duhet mbajtur aparat frymëmarrjeje autonom dhe veshje mbrojtëse e plotë.
<b>Mbrojtja e zjarrfikësve</b>	Largojini enët nga zona e zjarrit, nëse mund të veproni kështu pa rrezik.

#### 6. Masa në rast çlirimi aksidental

<b>Masa mbrojtëse personale</b>	Shmangni ekspozimin e zgjatur. Mbajeni larg personelin e panevojshëm. Në rast derdhjeje, tregoni kujdes me dyshemetë dhe sipërfaqet e rrëshqitshme. Për mbrojtje personale, shihni seksionin 8 të kësaj Dëftese.
<b>Masa mbrojtëse mjedisore</b>	Shmangni shkarkimin në kanale shkarkimi, rrjedha uji ose në tokë.
<b>Metodat e kontrollit të derdhjeve</b>	Ndalen rrjedhën e materialit, nëse mund ta bëni këtë pa rrezik. Argjinojeni materialin e derdhur, nëse mund ta bëni këtë.
<b>Metodat e pastrimit</b>	Fshijeni ose mblidheni materialin dhe pastaj largojeni. Pastroni me material absorbent (p.sh. leckë thithëse, shparcë). Pasi të pastroni, shpëlani mbeturinat me ujë. Për eliminimin e mbetjeve, shihni seksionin 13 të kësaj dëftese.

#### 7. Trajtimi dhe magazinimi

<b>Trajtimi</b>	Shmangni ekspozimin e zgjatur. Adoptoni praktika të higjienës së mirë industriale. Është praktikë e higjienës së mirë industriale që të minimizohet kontakti me lëkurën.
<b>Magazinimi</b>	Magazinoni në enën origjinale të mbyllur mirë.

#### 8. Kontrollë të ekspozimit / mbrojtja personale

<b>Kufijtë e ekspozimit në vendin e punës</b>	Nuk njihen caqe ekspozimi për përbërësin/t.
<b>Procedurat e rekomanduara të monitorimit</b>	Ndiqu procedurat standard të monitorimit.

**Kontrollet inxhinierike** Duhet përdorur ajrim i mirë i përgjithshëm (si rregull, 10 ndërrime ajri në orë). Shpejtësia e ajrimit duhet të përkojë me rrethanat. Nëse kjo mund të bëhet, përdorni hapësira të mbyllura përpunimi, ajrim me shkarkim lokal ose kontrolle të tjera inxhinierike, për të mbajtur nivelet e ndotjes ajrore nën caqet e rekomanduara të ekspozimit. Në qoftë se nuk janë vendosur caqe ekspozimi, mbajeni ndotjen ajrore në një nivel të pranueshëm.

**Pajisjet mbrojtëse personale**

**Mbrojtja për sytë/fytyrën** Nëse ka gjasë për kontakt, rekomandohen syze të sigurisë me mburoja anësore. Rekomandohet çezmë për larjen e syve.

**Mbrojtja për lëkurën** Përdorni veshje mbrojtëse të përshtatshme.

**Mbrojtja për frymëmarrjen** Në rast ajrimi të pamjaftueshëm, përdorni pajisje të përshtatshme për frymëmarrje.

**Mbrojtja për duart** Në rast kontakti të zgjatur ose të përsëritur me lëkurën, përdorni dorashka mbrojtëse të përshtatshme. Dorashkat e përshtatshme mund të rekomandohen nga furnitori i dorashkave.

**9. Vetitë fizike dhe kimike**

**Pamja**

**Gjendja e lëndës** Lëng.

**Ngjyra** Kafe e errët.

**Forma** Pastë.

**Aroma** Asnjë.

**Pragu i aromës** Nuk ekziston.

**pH** Neutrale.

**Pika e shkrirjes/pika e ngrirjes** Nuk ekziston.

**Pika e vlimit** > 220 °F (> 104.44 °C)

**Pika e flakërimit** Nuk ekziston.

**Shpejtësia e avullimit** Nuk ekziston.

**Ndezshmëria (e ngurtë, gaz)** Nuk zbatohet.

**Caqet e ndezshmërisë në ajër, i ulëti, % sipas volumit** Nuk zbatohet.

**Caqet e ndezshmërisë në ajër, i larti, % sipas volumit** Nuk zbatohet.

**Trysnia e avullit** Nuk ekziston.

**Dendësia e avullit** Nuk ekziston.

**Dendësia relative** > 1 (Uji = 1)

**Tretshmëria/të**

**Tretshmëria (në ujë)** Krejtësisht e tretshme në ujë.

**Koeficienti i përndarjes (n-oktanol/ujë)** Nuk zbatohet.

**Temperatura e vetëndejes** Nuk ekziston.

**Temperatura e shpërbërjes** Nuk ekziston.

**Viskoziteti** Nuk ekziston.

**Të dhëna të tjera**

**Vetitë shpërthyes** Jo plasëse.

<b>Ndezshmëria</b>	Jo e ndezshme. (WHMIS/OSHA/NOM-018-STPS 2000)
<b>Vetitë oksiduese</b>	Jo oksiduese.

## 10. Qëndrueshmëria dhe reaktiviteti

<b>Reaktiviteti</b>	Produkti është i qëndrueshëm dhe jo-reaktiv në kushte normale përdorimi, magazinimi dhe transportimi.
<b>Qëndrueshmëria kimike</b>	Materiali është i qëndrueshëm në kushte normale.
<b>Mundësi reaksionesh të rrezikshme</b>	Nuk njihen reaksione të rrezikshme në kushtet e përdorimit normal.
<b>Rrethana për t'u shmangur</b>	Asnjë që njihet.
<b>Materiale të papajtueshme</b>	Asnjë.
<b>Produkte të rrezikshme të shpërbërjes</b>	Nuk njihen produkte të rrezikshme të shpërbërjes.

## 11. Të dhëna toksikologjike

<b>Rrugët e ekspozimit</b>	Kontakti me lëkurën. Kontakti me sytë.
<b>Të dhëna toksikologjike</b>	Ekspozimi ndaj lëndës ose përzierjes gjatë punës mund të shkaktojë efekte të padëshiruara.
<b>Toksiciteti akut</b>	Pritet të ketë rrezikshmëri të ulët në rast gjëllitjeje.
<b>Gërryerje/irritim i lëkurës</b>	Në bazë të së dhënave ekzistuese, kriteret e klasifikimit nuk përmbushen.
<b>Dëmtim/irritim serioz i syve</b>	Kontakti i drejtpërdrejtë me sytë mund të shkaktojë irritim të përkohshëm.
<b>Përndjeshmues i rrugëve të frymëmarrjes</b>	Nuk është përndjeshmues i rrugëve të frymëmarrjes.
<b>Përndjeshmim i lëkurës</b>	Ky produkt nuk pritet të shkaktojë përndjeshmim të lëkurës.
<b>Mutageniciteti</b>	Nuk ka të dhëna në dispozicion, të tilla që të tregojnë se produkti ose ndonjë prej përbërësve i pranishëm në masë më të madhe se 0.1% janë mutagenikë ose gjenotoksikë.
<b>Kancerogjeniteti</b>	Ky produkt nuk konsiderohet si kancerogjen nga IARC, ACGIH, NTP, ose OSHA.
<b>Toksiciteti riprodaktiv</b>	Ky produkt nuk pritet të shkaktojë efekte në riprodhim ose në zhvillim.
<b>Toksiciteti specifik për organin e shënjestruar - një ekspozim i vetëm</b>	Nuk disponohen të dhëna.
<b>Toksiciteti specifik për organin e shënjestruar - ekspozim i përsëritur</b>	Nuk disponohen të dhëna.
<b>Rrezikshmëria në aspirim</b>	Nuk ka rrezikshmëri në aspirim.
<b>Efektet lokale</b>	Kontakti i drejtpërdrejtë me sytë mund të shkaktojë irritim të përkohshëm.
<b>Simptomat</b>	Kontakti i drejtpërdrejtë me sytë mund të shkaktojë irritim të përkohshëm.

## 12. Të dhëna ekologjike

<b>Ekotoksiciteti</b>	Produkti nuk klasifikohet si me rrezikshmëri për mjedisin. Megjithatë, kjo nuk përjashton mundësinë që derdhje të mëdha ose të shpeshta të kenë efekt të dëmshëm ose dëmtues ndaj mjedisit.
<b>Persistenca / degradueshmëria</b>	Nuk ka të dhëna për degradueshmërinë e këtij produkti.
<b>Bioakumulimi</b>	Produkti nuk pritet që të bioakumulohet.
<b>Mobiliteti</b>	Nuk ka të dhëna për këtë produkt.
<b>Efekte të tjera të</b>	Nga ky komponim nuk pritet të vijnë efekte të tjera mjedisore të padëshiruara (p.sh.

**padëshiruara** dëmtim i ozonit, potencial për krijimin fotokimik të ozonit, çrregullime endokrine, potencial për ngrohjen globale).

### 13. Udhëzime për eliminimin

**Mënyrat e eliminimit** Mblidhni dhe dorëzoni ose depozitoni në enë të mbyllura në një pikë të licencuar për eliminim të mbetjeve.

**Mbetja nga mbeturinat / produktet e papërdorura** Eliminoni në pajtim me rregulloret lokale.

**Ambalazhi i ndotur** Meqë enët e zbrazura mund të përmbajnë mbeturina të produktit, ndiqni udhëzimet e etiketës edhe pasi të jetë zbrazur ena. Enët e zbrazura duhen çuar te një pikë e miratuar për trajtimin e mbetjeve, ku të riciklohen ose të eliminohen.

### 14. Të dhëna për transportin

#### ADR

Nuk rregullohet si mall i rrezikshëm.

#### RID

Nuk rregullohet si mall i rrezikshëm.

#### IATA

Nuk rregullohet si mall i rrezikshëm.

#### IMDG

Nuk rregullohet si mall i rrezikshëm.

**Transportim masiv sipas Aneksit II të MARPOL 73/78 dhe Kodit IBC** Nuk zbatohet.

### 15. Të dhëna normative

#### Inventarët ndërkombëtarë

Vendi ose rajoni	Emri i inventarit	Në inventar (po/jo)*
Australi	Inventari Australian i Lëndëve Kimike (AICS)	Jo
Kanada	Lista e Lëndëve Vendore (DSL)	Jo
Kanada	Lista e Lëndëve Jo-Vendore (NDSL)	Jo
Kinë	Inventari i Lëndëve Kimike Ekzistuese në Kinë (IECSC)	Jo
Europë	Inventari European i Lëndëve Kimike Komerciale Ekzistuese (EINECS)	Jo
Europë	Lista Europiane e Lëndëve Kimike të Njoftuara (ELINCS)	Jo
Japoni	Inventari i Lëndëve Kimike të Reja ose Ekzistuese (ENCS)	Jo
Kore	Lista e Kimikateve Ekzistuese (ECL)	Jo
Zelandë e Re	Inventari i Zelandës së Re	Jo
Filipine	Inventari i Kimikateve dhe i Lëndëve Kimike në Filipine (PICCS)	Jo
Shtetet e Bashkuara & Puerto Rico	Inventari sipas Ligjit të Kontrollit të Lëndëve Toksike (TSCA)	Po

\*Një "Po" tregon se ky produkt pajtohet me kërkesat e inventarit të administruara nga shteti/et qeverisës/e.

Një "Jo" tregon se një ose më shumë përbërës të produktit nuk listohen ose janë përjashtuar nga listimi në inventarin e administruar nga shteti/et qeverisës/e.

### 16. Të dhëna të tjera

**Mohim i përgjegjësisë** Evident Scientific nuk mund të parashikojë të gjitha rrethanat në të cilat mund të përdoret ky informacion dhe produkti përkatës, ose produktet e fabrikantëve të tjerë në

kombinim me këtë produkt. Është përgjegjësi e përdoruesit që të sigurojë kushte të sigurta për trajtimin, magazinimin dhe eliminimin e produktit, dhe të marrë përgjegjshmëri për humbje, lëndime, dëme ose shpenzime të shkaktuara nga përdorimi i papërshtatshëm. Informacioni në këtë dëftesë u hartua në bazë të njohurive më të mira ekzistuese dhe të eksperiencës më të mirë aktualisht në dispozicion.

**Lista e shkurtimeve**

Nuk ekziston.